



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "PETRO SOTA" FIER

Nr. 680 Prot

Fier, më 22/10/2021

Lenda: Njoftim për vend të lirë

**AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
TIRANË**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit nr.14, datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësive të zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", nenit 109 "Shpallja e vendit të lirë për personel mësimdhënës të kultures profesionale me kohë të plotë"

Shkolla e mesme profesionale "Petro Sota" Fier, ju njofton krijimin e vendeve të lira për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale me kohë të plotë për pozicionet e mëposhtme :

1. 1 inxhinier mekanik
2. 1 inxhinier hidro
3. 1 inxhinier naftë

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kritere të posaçme

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të mësipërme;
- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a- letërmotivimin për pozicionin;
- b- jetëshkrimin (CV-në);
- c- kartën e identitetit;
- d- diplomën;
- e- Librezën e punës
- f- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendur në CV;
- g- certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurivënë teknologjinë e informacionit;
- h- vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i- vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j- vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k- të paktën një rekomandim ose vlerësim punëgjatësor nga punëdhënësi të mëparshëm.

1. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

- Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e sekretarisë së Shkollës së mesme profesionale "Petro Sota" Fier, brenda datës 11 / 11 /2021.

DREJTORI I SHKOLLËS

Arta LEKA

